



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik


01Nr. 104/02- 1493/23
Kaçanik, 31.01.2023

Në bazë nenit Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 10 lidhur me nenin 13 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060(Gazeta Zyrtare Nr. 04.L-060 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/29 Qershor 2012), të nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L -071 - për ndryshim plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 Për Mbeturina (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/1 shtator 2022), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të nenit 4 të Rregullores 01Nr. 07-60/01-17890/19 - Për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut, të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, duke vendosur sipas Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit 53-2/23 të datës 16.01.2023, për rishqyrtimin e vendimit të KK 01Nr. 07-104/02-33334/22 të datës 29.12.2022, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 31 janar 2023 mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE 2023-2027

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani komunal, me tekstin e mëtejshëm "Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027".
2. Plani komunal nga pika 1 e këtij vendimi, mundëson zbatimin e politikave kombëtare bë nivel lokal, orientimin strategjik të komunës drejt menaxhimit të integruar e të qëndrueshëm të mbeturinave, qasje të qartë të politikave të menaxhimit, mirëqeverisjen ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kuadrit rregullues ligjor.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Plani Komunal 01Nr. 104/02- 1493/23-Për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, i përmbledhur në 46 faqe.
4. Me këtë vendim, Anullohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, 01Nr. 07-104/02-33334/22 i datës 29.12.2022-për Aprovimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursefi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	22.02.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë	
01	104/02-1493	✓	



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕСПУБЛИКА КООСОВА
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nj. Org. / Org. / Unit: DL
Nj. / Post. / Post. No: 605-2/23
Data / Datum / Date: 21.02.23
PRISHTINË / A No 1

HYRESE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕСПУБЛИКА КООСОВА
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date: 22.02.2023
Nr. / Lembi / Vlera: 020-116/3

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësuese e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPH Servet Spahiu, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për vlerësimin ligjor Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të 2. Zyrtari hartues i Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit vlerësimin ligjor Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi 01Nr.104/02-1493/23 për aprovimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, miratuar nga Kaçanik.

I nderuari Kryetar Ilazi,
I nderuari Kryesues Murseli,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 06.01.2023, ka pranuar nga MAPL Vendimin 01Nr.104/02-1493/23 për aprovimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, miratuar nga Kaçanik, datë 31.01.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

K O N F I R M O N

Në parim vendimin 01Nr.104/02-1493/23 për aprovimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, miratuar nga Kaçanik, datë 31.01.2023.

A r s y e t i m i

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit 01Nr.104/02-1493/23 për aprovimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, miratuar nga Kaçanik, konstatoi se:

Vendimi 01Nr.104/02-1493/23 për aprovimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, miratuar nga KK Kaçanik, nuk është në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 dhe 13 të Ligjit NR. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/l-060 për Mbeturina.

Ndërsa, ju rekomandojmë që të rishikohet-përmirësohet neni 15 në të cilin jeni bazuar në hyrje të vendimit, pasi që dispozitat e këtij neni kanë pësuar ndryshime me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Kaçanikut dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 07-104/02-33334/22
Kaçanik, 29.12. 2022

Në bazë nenit Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), të nenit 10 lidhur me nenin 13 paragrafi 2 pika 1 dhe nenit 15 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060(Gazeta Zyrtare Nr. 04.L-060 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/29 Qershor 2012), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, të nenit 4 të Rregullores 01Nr. 07-60/01-17890/19 - Për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Kaçanikut. të nenit 6.2, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28 Korrik 2022 mori këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E
MBETURINAVE 2023-2027

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani komunal, me tekstin e mëtejshëm "Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027".
2. Plani komunal nga pika 1 e këtij vendimi, mundëson zbatimin e politikave kombëtare në nivel lokal, orientimin strategjik të komunës drejt menaxhimit të integruar e të qëndrueshëm të mbeturinave, qasje të qartë të politikave të menaxhimit, mirëqeverisjen ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kuadrit rregullues ligjor.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është: Plani Komunal 07-104/02-33334/22 -Për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, i përmbledhur në 46 faqe.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kempal Murseli